

**Grupi "Manesh" promovon albumin e tyre të parë**

# "Trickster Calls" albumi i parë i grupit zvicerano-kosovar

"Manesh" u prit me entuziazëm të madh nga të rinjtë e qytetit të Lucernit, ku djelmoshat e këtij grupi e promovuan albumin e tyre te parë. Planet e Grupit Manesh janë të shumta, por në fillim ata do të organizojnë shumë koncerthe në tèrë Zvicrën, dhe ata premtojnë se në planet e tyre aktive - muzikore është edhe organizimi i një koncerti të madh në Kosovë



## Leonora Shala

Ndër meloditë më mbresëlënëse të grupit "Manesh", i cili është i përbërë nga dy shqiptarë dhe dy zviceranë, ishin edhe ato kushtuar Kosovës, njëra me titullin "Prishtinë", e cila është punuar pikërisht më 17 shkurt 2008, ditën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe melodia tjetër "1998" që bart atmosferën e luftës në Kosovë gjatë vitit 1998. Në mbrëmjen e promovimit të albumit të këtyre djelmoshave ishin tubuar me dhjetëra të rinj. Grupi Manesh është formuar nga katër djem që janë me origjinë nga vendet e ndryshme, por që muzika i ka bashkuar në një grup të vetëm dhe shumë të fortë, nga të cilët dy janë shqiptarë, vëllezërit Bujar dhe Besart Berisha. Është themeluar para rrëth tri vitesh dhe deri më tash ka bërë disa depërtime tejet të suksesshme në skenën muzikore të Lucernit dhe rrëthinës saj.

## Kurorëzimi i një pune të suksesshme tri vjeçare

Albumi i promovuar me titull "Trickster Calls" të grupit

muzikor "Manesh" i përbërë nga dy muzikantë shqiptarë dhe dy zviceranë kultivon muzikë rok alternative dhe ka këtë përbërje: Michael Hunkeler (vokal dhe violinë), Besart Berisha (kitarë), Bujar Berisha (bass) dhe Marco Zimmermann (bateri). Përveç promovimit, "Manesh" në këtë mbrëmje dha edhe një koncert ku pati mysafrë edhe dy grupe tjera, të reja Marochine dhe Schmutzpartikel.

Katër djelmoshat e këtij grupi sikur në paraqitjet e deri-tashme, edhe në këtë mbrëmje arriten të fitojnë simpatinë e publikut, kryesisht të ri dhe të përbërë nga zviceranë. Me këtë promovim ata kanë kurorëzuar me sukses punën e tyre të përbashkët afér tri vjeçare. Ndërmjetë më mbresëlënëse ishin edhe ato kushtuar Kosovës, njëra me titullin "Prishtinë", që është punuar pikërisht më 17 shkurt 2008, ditën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe melodia tjetër "1998" që bart atmosferën e luftës në Kosovë gjatë vitit 1998. Me të përmendur të pavarësisë së Kosovës nga solisti Michael Hunkeler, në sallë jehoi një duartrokitje nga

ana e të pranishmëve.

Bujar Berisha shpjegon sesi ka bërë muzikë së bashku me vëllanë tash e një kohë të gjatë dhe se tash është mishëruar me instrumente. Ndërkaj rrëth njoħes me kolegët tjerë tregon se si me Michaelin është njoħur në shkollë ku edhe kanë shpreh dëshirë të formonin një grup gjë që edhe ia kanë arritur kësaj ideje ta zbatojnë me sukses në praktikë. Bujari tregon më tej se si për një vit kanë bërë muzikë së bashku, ndërsa që grupin "Manesh" e kanë u formuar më vonë. Më pastaj në grup e kanë marrë edhe anëtarin më i ri Marco Zimmerman, kjo ka bërë siç nénvizon rrëth që grupi të bëhet jo vetëm më i kompletuar por edhe më profesionist. Ndërkaj i riu zviceran, Michael Hunkeler, që ekzekuton me violinë dhe këndon për grupin, ka kryer një shkollë muzikore edhe shkolla speciale private të violinës. Ai thotë se gjatë kësaj kohe kanë dhënë koncerthe të ndryshme dhe se me këtë album kurorëzohej puna e tyre e përbashkët. Po ashtu shton se koncertet i kanë mbajt kryesisht në Lucern me rrëthinë dhe se incizimi na ka marrë po

ashtu një kohë të gjatë, për çka edhe me koncerthe është dashur të pauzohet. Porse siç e vërtetojnë të gjithë kjo do të shpaguhet me këtë album që e konsiderojnë si shumë suksesshëm. Djaloshi, Besart Berisha, që nga vegjelia ishte i pasionuar pas kitarës, për çka edhe shtatë vite ka bërë mësim për këtë instrument dhe aktualisht punon në një shitore të specializuar të instrumenteve muzikore. Mësojmë se ai ka në plan e dëshirë që të bëhet mësues i kitarës dhe kështu të jetë ndër mësuesit e parë shqiptar të kitarës në këtë pjesë të Zvicrës. Djaloshi më i ri në këtë grup, Marco Zimmerman ka mësuar të ekzekutojë me bateri (timpanë) që nga mosha katër vjeçare nga babai dhe pastaj disa vite ka ndjekur shkollimin për të perfeksionuar këtë instrument. Kështu që ai në grup paraqet një sihariq të vërtetë.

## Koncert të madh në Kosovë

Vlen të theksohet se grupi "Manesh" për një kohë e sidomos muajve të fundit ka qenë shumë i pranishëm në mediet e Lucernit dhe të Zvicrës qen-

drore. Fakti se meloditë instrumentale dhe këngët e grupit dëgjohen çdo ditë në shumë radiostacione lokale dhe regionale të kësaj pjese e kanë bërë këtë grup edhe më të afërm e të dashur me dëgjuesit.

Ndërkaj sa i përket planeve të tyre për të ardhmen këta të rinj si në një zë thonë se presim që të kenë sa më shumë paraqitje, koncerthe, apo edhe ndonjë cd të e dhe çka është kryesorja edhe shumë adhurues. Planet e Grupit Manesh janë të shumta, por në fillim ata do të organizojnë shumë koncerthe në tèrë Zvicrën, dhe ata premtojnë se në planet e tyre aktive - muzikore është edhe organizimi i një koncerti të madh në Kosovë. Ata thonë njëzëri që me instrumentet e tyre muzikore, mund të bëjnë gjëra shumë të mëdha në muzikë. Rok muzika të gjallëron jo vetëm trupin, por edhe mendjen, shprehen ata. Këngët që ata i kanë kënduar deri me tanë, i përkasin zhanreve të ndryshme të muzikës dhe mes tyre mund të gjesh muzikë bluzë, funky, rock dhe ata e quajnë këtë stil muzikor të të kënduarit: rock - alternativë.